

AKTI I THEMELIMIT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

(1) Sot më datë, 22 .01.2025 (dymijë e njëzetë e pesë), të pranishëm ;

a. Anxhelo Golgota , i bri i Pavllos dhe i Tania, lindur më 01.06.1968 dhe banues në Durres në adresën Lagja nr. 11, Rruga Aleksander Goga , Nd 758 , Hyrja 1, Ap 8 , në moshë madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me shtetësi shqiptare, i identifikuar me nr ID G80601291F.

b. Andi Jovani, i bri i Vangjelit dhe i Dallandyshe, lindur më 03.08.1975 dhe banues në Durres në adresën Lagja nr.16, Rruga Edith Durham , Nd 5 , Hyrja 6, Ap 10 , në moshë madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me shtetësi shqiptare, i identifikuar me nr .ID H50803101O .

c. Agron Hyseni , i bri i Petritit dhe i Ishes ,lindur më 11.01.1976 banues në Durres në adresën Lagja nr.18, Rruga Mbreti Pirro, Nd 31, në moshë madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me shtetësi shqiptare, i identifikuar me nr. ID H60111146P.

d. Gentian Ballgjini , i bri i Eqeremit dhe i Vjollces, lindur më 29.09.1978 banues në Durres në adresën Lagja nr.4, Rruga Egnatia , Nd.922, Hyrja 1, Ap 11 , në moshë madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me shtetësi shqiptare, i identifikuar me nr. ID H80929057C.

e. Agron Bejko , i bri i Nezirit dhe i Zylfies , lindur më 05.06.1965 banues në Durres në adresën Lagja nr.13, Rruga, Pavarsia Nr 149 , në moshë madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me shtetësi shqiptare, i identifikuar me nr. ID G50605081D.

Ortakët me vullnet të lire e të plotë, mbështetur në Ligjin nr. 9901, datë 04.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, shpallin hartimin dhe nënshkrimin e këtij Akt - themelimi si më poshtë vijon:

Neni 1 EMËRTIMI

Themelohet një shoqëri tregëtare me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin

“Dough Harmony” sh.p.k.

Neni 2

SELIA

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën; Njesia administrative nr.3, Lagja 12, Rr “Marin Barleti” , Nd 4 H4, Durrës , Shqiperi.

Shoqëria me vendim të asamblese së përgjithëshme të ortakëve , mund të hap seli dytësore , filiale zyra përfaqësimi , dege ose agjensi si në Shqipëri ashtu dhe jashtë saj.

Neni 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar. Afati fillon nga momenti i regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin e Shoqërive Tregëtare deri sa të mbyllet me akte ligjore.

Neni 4

OBJEKTI

Të operojë në fushën e Prodhimit të Produkteve dhe nënprodukteve me bazë Brumi, Bukë, Croissant, Produkte Pasticërie, Shitje me Shumicë-Pakicë, Export

Shoqëria do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj;

Prodhimin e produkteve të lartëpërmendura me receptura e vlera ushqimore të ndryshme, të mirëpraktuara dhe të respektuara sipas standarteve të Bashkimit Europian.

Prezantim dhe afrim të produkteve për Ushqim bio- natyrale për përmirsimin e prodhimit si dhe mjete e pajisje për përpunimin e Brumit;

Shkëmbim eksperience për prodhuesit brenda dhe jashtë vendit;

Import të lëndëve të para për teknologjinë e përpunimit të brumërave etj dhe Nënprodukte të tyre;
Eksport i prodhimeve ushqimore, të lartëpërmendura.


Neni 5

KAPITALI THEMELTAR

(1) Kapitali themeltar i shoqërisë është 1 000 (njëmijë) lekë, e cila përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë, është i ndarë në 5 (pesë) kuota.

(2) Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- a. Anxhelo Golgota, zotëruesi i 1 (një) kuotë që përbën **15%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- b. Andi Jovani, zotëruesi i 1 (një) kuotë që përbën **20%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- c. Agron Hyseni, zotëruesi i 1 (një) kuotë që përbën **20%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- d. Gentian Ballgini, zotëruesi i 1 (një) kuotë që përbën **25%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- e. Agron Bejko, zotëruesi i 1 (një) kuotë që përbën **20%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.



(1) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/palujtshme apo të drejta).

Neni 6

ORGANET E SHOQËRISË

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë, që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e Shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë në çështjet e mëposhtme:

- a. përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b. emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
- c. emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve, audituesve ligjorë dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përcaktuar në pikat “b” dhe “c”;
- e. mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- f. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- g. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- h. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- j. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit.
- k. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjes së asamblesë
- l. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.



NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë .

Për sa nuk parashikohet në këtë Akt -Themelimi dhe Statut do të zbatohet dispozitat e ligjit 9901, datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”i ndryshuar, Kodi Civil e çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, apo edhe midis vetë ortakëve apo punonjësve të saj, do të jetë Gjykata kompetente .

NENI 9

DISPOZITA FINALE

Ky Akt- Themelimi u hartua nga vetë ortakët në 6(gjashtë) ekzemplarë me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike në gjuhën Shqipe.

Akt - Themelimi nënshkruhet prej ortakëve pa asnjë rezervë.


ORTAKËT THEMEUES

të “Dough Harmony” sh.p.k.


Anxhelo Golgota




Agron Hyseni



Agron Bejko



Andi Jovani



Gentian Ballgjini

